# DËSHMI ARKIVI

**A-452216**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sara Hoxha rikthehet në ekran, këtë herë si moderatore |
| ADRESA | `https://piranjat.al/showbiz/sara-hoxha-rikthehet-ne-ekran-kete-here-si-moderatore-i104635` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 12:13:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 11:57:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `34a5a68d22d4003f1aea1438e34d11627d205534a2403f59292c6bb6de05e9e4` |
| TEKSTI | `c201ac7a96984a08633f2d2738b649822795ff0d79012d75003a88ae087a29ed` |
| PAMJA | `94b564438acd602836f81ff970a2d1991332216fa59c3ef45354abb58491c400` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4e03a3780d73a24dbed624a4379ac2b06bfb36d3052a7da7ab67000449ff6448` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4e03a3780d73a24dbed624a4379ac2b06bfb36d3052a7da7ab67000449ff6448`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flash: Greqi! Dyshohet është kthyer ■ mbrojtjen e Evropës. A do ta bërë amerikanët të ndihen si në ■ pas tubimit të së hënës zhvilluar të hënën në ■ marrë me vete në drejtua socialsitëve duke i thënë ■ në polici edhe 'diali' i afërsi të selisë së Partisë Demokratike...


SHOWBIZ

# Sara Hoxha rikthehet në ekran, këtë herë si moderatore

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 13:57



Sara Hoxha po provon një tjetër dimension të televizionit. Pas eksperiencës si konkurrente, anëtare jurie dhe aktore, këtë herë ajo do të marrë drejtimin e një rubrike të sajën në Top Channel. Duke nisur nga e diela, 20 shtator, Sara do të moderojë "Me Gjithë Zemër", rubrika më e re e programit "E Diell", e ndërtuar rreth historive personale, surprizave dhe emocioneve.

Nga prezantimi i parë i formatit, publiku mund të bëhet vetë pjesë e tij duke propozuar historitë që dëshiron të sjellë në ekran. Mund të jetë një falënderim që nuk është thënë kurrë, një kërkim faljeje, një propozim martese apo një surprizë për dikë të rëndësishëm.

Koncepti e vendos Sarën për herë të parë në pozicionin e personit që duhet të udhëheqë rrëfimet e të tjerëve, një rol ndryshe nga ato me të cilat publiku e ka parë deri tani.

Historia e saj me Top Channel nisi në sezonin 2022-2023 të "Dancing With The Stars", ku Sara garoi së bashku me Luixhino Halën dhe në fund fitoi spektaklin.

Më pas erdhi pikërisht "E Diell". Në vitin 2023, Sara iu bashkua programit si anëtare e jurisë së "She's On Top", krah Dea Mishel dhe Krist Aliajt.

Po atë vit provoi edhe aktrimin, duke interpretuar Arian në filmin "Në Kuadër të Dashurisë".

Tani rikthehet në të njëjtin program ku dikur ishte pjesë e jurisë, por me një përgjegjësi tjetër. Për herë të parë, Sara Hoxha do të ketë në dorë drejtimin e një hapësire televizive.

"Me Gjithë Zemër" sjell ndërkohë në kujtesë traditën e formateve që ndërtohen mbi histori reale dhe surpriza emocionale, të njohura prej vitesh edhe për publikun shqiptar. Megjithatë, struktura e plotë dhe mënyra se si do të zhvillohet rubrika e re do të bëhen më të qarta me premierën.

Nga fituese e "Dancing With The Stars", te juria, kinemaja dhe tani moderimi: 20 shtatori shënon një tjetër provë televizive për Sara Hoxhën, këtë herë "Me Gjithë Zemër".

## Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 17 Shtator09:40

**Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim Robbins pas 23 vitesh bashkë? "Kam frikë se mos…"**

Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga &cc...

SHOWBIZ 16 Shtator22:02

[Libri i Charles Spencer zbulon përplasjen me mbretin Charles pas vdekjes së Lady D: Do ta harrojmë shpejt Dianën]

Familja mbretërore britanike pritet të përballet me zbulime të reja mbi periudhën pas vdekjes së Princeshës Diana, përme...

SHOWBIZ 16 Shtator19:41

[Grabitja, gjykata franceze i akordon 1 euro Kim Kardashian]

Një gjykatë në Paris i akordoi të martën 1 euro (1.15 dollarë) Kim Kardashian si dëmshpërblim, pasi ajo ishte viktim&eum...

SHOWBIZ 16 Shtator18:55

[Rogert Sterkaj i kërkon në gjykatë fitueses së "BBV4" 10 mijë euro]

Rogert Sterkaj ka kërkuar asistencë ligjore pranë avokates Aurora Marku lidhur me paratë e çmimit të fituar nga Selin Bollati dh...

SHOWBIZ 16 Shtator15:06

[Maluma bëhet baba për herë të dytë, zbulon emrin e veçantë të djalit]

Familja e Maluma-s është zgjeruar sërish! Këngëtari kolumbian dhe partnerja e tij, Susana Gómez, kanë mirëpritur n&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator23:14

[Nora publikon video 'të nxehta' nga pushimet]

Këngëtarja e njohur shqiptare, Nora Istrefi vazhdon të jetë njëra ndër këngëtaret me të pëlqyera për publ...

SHOWBIZ 15 Shtator22:43

[Substancë para plazmaferezës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit]

Hetimi për vdekjen e Giorgos Mazonakis po merr një tjetër drejtim, ndërsa autoritetet greke po fokusohen te provat dixhitale të sekuest...

SHOWBIZ 15 Shtator22:35

[Bebe Rexha flet për vizitat e shpeshta që bënte në Maqedoni gjatë fëmijërisë: Dasmat shqiptare zgjasnin deri në 3 të mëngjesit]

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Bebe Rexha, ka folur së fundmi për kujtimet e saj të fëmijëris&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator22:13

["Ky vit do të jetë ndryshe", Xhensila Myrtezaj me premtim të madh për fansat]

Këngëtarja e njohur, Xhensila Myrtezaj, ka ndarë me ndjekësit disa momente nga koncertet e saj, duke shoqëruar fotografitë dhe vid...

SHOWBIZ 15 Shtator22:01

[Ka gjetur dashurinë pas divorcit? Këngëtarja Maya "hap zemrën"]

Këngëtarja e njohur Maya Aliçkaj ka folur për jetën e saj private gjatë një interviste duke treguar se aktualisht jeton vet...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...]

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...]

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...]

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



## E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.